




RAYS

Reconnecting Albanian Youth and Society


HYRJE NË KOMPOZIMIN E PEIZAZHIT TINGULLOR

Manual për profesionistët



Hyrje në Kompozimin e Peizazhit Tingullor

Manual për profesionistët



Autorët:

Panos Amelidis (kompozimi i peizazhit tingullor)
Stephanie Schwandner-Sievers dhe Emily Fisher
(Strategjia FAM)

Falënderojmë Arnold Kapinovën dhe Idila
Ibrahimin që bënë të mundur aktivitetet
bashkëpunuese dhe hulumtimet në rastet
studimore për kompozimin e peizazhit tingullor në
Shqipëri në vitin 2022.

*Shënim: Ky document u hartua me mbështetjen e
projektit Rilidhja e Rinisë dhe Shoqërisë Shqiptare
(RAYS). Opinione të shprehura janë të autorëve
dhe jo domosdoshmërisht shprehin pikpamjet e
projektit dhe Qeverisë Britanike.*

Përmbajtja

NJIHUNI ME EKIPIN	5
1. HYRJE	8
2. STUDIMET DHE TERMINOLOGJIA E PEIZAZHIT TINGULLOR	12
3. TË KUPTOJMË VENDIN NËPËRMJET TË DËGJUARIT	16
4. REGJISTRIMI SI PROCES TRANSFORMIMI	17
5. EDITIMI – BURIME NË INTERNET	18
6. ZBATIMI NË ARSIM – STRATEGJIA FAM	19
7. PLANI I SEMINARIT	22
REFERENCAT	33
SHTOJCA 1: SHEMBUJ TË MATJES PARAPRAKE TË PULSIT (VETËM SI PYETËSOR)	34
SHTOJCA 2: SHEMBULL FLETE DETYRE PËR EKSPLORIMIN	36

NJIHUNI ME EKIPIN

● DR. PANOS AMELIDIS

Jam kompozitor, artist dhe akademik muzike. Puna dhe hulumtimet e mia lidhen me fushën e etnografisë shqisore me zërin dhe rolin e të folurit të regjistruar, dhe me peizazhin tingullor për sa i përket mënyrës se si mund të krijohen vepra dhe mesazhe të reja artistike muzikore. Po ashtu, hulumtimet lidhen edhe me rolin e punës artistike mbi ndërgjegjësimin për rëndësinë e trashëgimisë kulturore. Rëndësi e veçantë i kushtohet sinergjisë së regjistrimeve të peizazhit tingullor, rrëfimit me gojë, teknologjisë dhe mundësive që ofrojnë studiot elektroakustike.

Kam studiuar Muzikë dhe Informatikë Muzikore në Universitetin Jonian (Greqi) dhe kam përfunduar programin Master në Muzikë në Kompozimin Elektroakustik dhe Media Interaktive në Universitetin e Mançesterit. Në vitin 2015 përfundova doktoratën në Teknologji Muzikore në Universitetin De Montfort. Jam pedagog i Teknologjisë Muzikore dhe Audio në Departamentin e Teknologjisë Krijuese dhe anëtar bordi i Qendrës Kërkimore të Mediave Eksperimentale EMERGE në Universitetin Bournemouth.

● DR. STEPHANIE SCHWANDNER-SIEVERS

Jam profesreshë e asociuar në Antropologji të Aplikuar në Universitetin Bournemouth. Më parë kam drejtuar Programin e Studimeve Shqiptare në Katedrën e Studimeve Sllave dhe të Evropës Lindore, në Kolegjin Universitar Londër (1997 – 2003) pas diplomimit në dy degë njëkohësisht: Ballkanologji dhe Antropologji Sociale, specializuar për kulturat dhe shoqëritë shqiptare. Tashmë po i rikthehem punës që kam bërë për më shumë se tre dekada në etnografi si dhe bashkëpunimeve kërkimore në Shqipëri, në mbarë rajonin, dhe në nivel ndërkombëtar, ku vitet e fundit kam punuar përherë e më shumë nëpërmjet metodave të artit me pjesëmarrje, si në vendin tim ashtu edhe në mbarë botën (p.sh., shih <https://changingthestory.leeds.ac.uk/> dhe <https://www.bournemouth.ac.uk/research/centres-institutes/centre-seldom-heard-voices>).

Muzika ka qenë gjithmonë një nga pasionet e mia. Ky projekt më ka bërë të mundur të përfshij të rinj, studentë e kolegë, nga Shqipëria por edhe nga Mbretëria e Bashkuar, në një rrugëtim bashkë-krijues zbulimi të vetvetes, duke u mbështetur në zhvillime rigorozë metodologjike dhe teorike të frymëzuara nga antropologjia dhe kërkimet e hershme për veprimin me pjesëmarrje, e përmbledhur në Strategjinë FAM – gjithmonë duke hulumtuar se si artet, veçanërisht muzika, mund të na ndihmojnë të imagjinojmë, krijojmë dhe kërkojmë një të ardhme më të mirë për të gjithë, përtej ndasive shoqërore dhe kundër paragjykimëve që shfaqen kudo.

● EMILY FISHER

Aktualisht studioj Sociologji dhe Antropologji Sociale në Universitetin e Bournemouth dhe punoj si asistente kërkimore për Projektin RAYS, duke ndihmuar Dr. Stephanie Schwandner-Sievers në hartimin e strategjisë FAM që përshkruhet me më shumë hollësi në këtë manual.

Kam punuar së bashku me Idila Ibrahimin dhe Arnold Kapinovën për të organizuar seminare pilote në Shkodër, duke bashkë-krijuar kompozime të peizazhit tingullor me të rinj gjatë muajit shtator 2022. Kam parë sesi ky medium artistik kishte potencialin për të nxitur të rinjtë të ndryshonin këndvështrimet dhe të angazhoheshin me mjedisin rrethues në forma të ndryshme.

Si dikush që sapo ishte njohur me kompozimin e peizazhit tingullor si metodë, mahnitesha kur dëgjoja versionet përfundimtare të regjistrimeve dhe kur kuptoja pushtetin që mund të ketë tingulli tek të rinjtë.

● IDILA IBRAHIMI

Aktualisht punoj si asistente kërkimore në Projektin RAYS Albania ndërkohë që po punoj edhe me tezën e diplomës në Universitetin e Prishtinës në Kosovë, Departamenti i Antropologjisë Kulturore. Gjatë studimeve u bëra pjesë e Programit të Shkëmbimit të Studentëve ERASMUS+ dhe studiova një semestër në Antropologji Sociale në Universitetin e Bournemouth, ku pata mundësinë për t'u takuar me Dr. Stephanie Schwandner-Sievers dhe për t'u përfshirë në projekt, një mundësi e jashtëzakonshme e që të ndryshon jetën.

Në korrik 2022 ndihmova në realizimin e dy seminare pilote në Shqipëri që kishin në fokus ndërhyrjet muzikore dhe artistike me të rinj nga Kukësi dhe Shkodra, me fokus të veçantë në muzikën hip-hop, së bashku me Dr. Mark Berry dhe Arnold Kapinova me bashkëpunimin, udhëzimet dhe mbështetjen e vazhdueshëm nga Dr. Stephanie Schwandner-Sievers dhe Emily Fisher.

Më vonë, në shtator, organizuam seminarin e dytë pilot me bazë arti me të rinj nga Shkodra, duke u fokusuar në rrëfime përmes prodhimeve audio dhe zanore së bashku me Arnold Kapinovën dhe Emily Fisher, me bashkëpunimin, drejtimin dhe mbështetjen e vazhdueshme të Dr. Panos Amelidis dhe Dr. Stephanie Schwandner-Sievers.

Kontributi im në të dy projektet vjen nga interesi dhe dashuria ime për muzikën dhe artin, etnografinë dhe punën me projekte që e kuptojnë rëndësinë e jashtëzakonshme të analizimit të çështjeve nga një këndvështrim antropologjik.

● ARNOLD KAPINOVA

Për shkak të interesit që kam pasur në fenomenologji gjatë viteve studentore, kisha dëgjuar diçka për konceptin e peizazhit tingullor më parë. Megjithatë, kisha shumë pak njohuri për të. Kur ndoqa për herë të parë seminarin e Dr. Panos për krijimin e peizazhit tingullor, e kuptova se sa e mrekullueshme është të luash me tingullin dhe magjinë e tij.

Në atë kohë, punoja në një qendër komunitare me fëmijë që i përkisnin një komuniteti të marginalizuar. Menjëherë më erdhi mendimi t'i vija në praktikë aftësitë e reja të fituara në kurrikul; fëmijët e qendrës do ta pëlqenin shumë një gjë të tillë.

Kështu nisi rrugëtimi im në botën e peizazhit tingullor. Isha shumë i lumtur kur Palladium më kontaktoi më vonë për të ndihmuar Dr. Panos Amelidis në realizimin e trajnimit për krijimin e peizazhit tingullor për profesionistë në Shkodër dhe më vonë në Elbasan. Në fillim të shtatorit 2022, më në fund arrita të bashkëpunoja për zhvillimin dhe zbatimin e një seminari që krijonte peizazhin tingullor në bashkëpunim me të rinj nga Shkodra.

Nëpërmjet seminareve të peizazhit tingullor, kam hyrë në një botë të re, në botën e tingullit. Përdorimi i tingullit si një mjet alternativ për të treguar një histori është i nevojshëm në kulturën tonë që drejtohet nga pamja e jashtme. Mund të na ndihmojë të jemi më kritikë dhe të përqendrohemi në mjedisin tonë rrethues. Mund të na ndihmojë të lidhemi me mjedisin tonë dhe të zhvillojmë një ndjenjë më të mirë për botën që na rrethon.

Në këtë drejtim, jam shumë e lumtur që kam qenë pjesë e këtij projekti; që do të thotë se kam dhënë kontributin tim modest në të gjithë këtë, të cilin e konsideroj të një rëndësie të madhe. Ka qenë edhe një përvojë mjaft e dobishme për sa i përket rritjes personale. Në fund, shpreh mirënjohjen time për të gjithë njerëzit që më kanë mbështetur gjatë gjithë këtij rrugëtimi, Dr. Panos Amelidis, Dr. Stephanie Schwander-Sievers, Idila Ibrahimini dhe Emily Fisher.

1. HYRJE

Ky manual ofron një udhëzues të hollësishëm për formën dhe kontekstin e zbatimit të kompozimit të peizazhit tingullor si një aktivitet për angazhimin e të rinjve. Kompozimi i peizazhit tingullor është një instrument krijues dhe pedagogjik që nxit angazhimin ndijor, transformues, kritik dhe krijues të të rinjve me mjedisin e tyre shoqëror dhe natyror. Ky kompozim mund të zbatohet si në arsimin formal ashtu edhe në atë joformal; mund të përdoret me të rinjtë vulnerabël dhe të marginalizuar; dhe është i nevojshëm për të trajtuar tema të ndjeshme në mjedise e situata të vështira. Ai nxit zhvillimin e aftësive të të dëgjuarit aktiv dhe u mundëson të rinjve të lidhen me vendin, kulturën dhe shoqërinë e tyre ndërkohë që bën të mundur forma joverbale që të rinjtë mund t'i përdorin për të treguar historitë e tyre. Për më tepër, ai tërheq dhe zhvillon më tej aftësitë dhe njohuritë informatike që të rinjtë mund t'i kalojnë tek njëri tjetri.

“Të dëgjosh i përqendruar hapësirat e njohura (p.sh., shkolla, klasa, rruga e zhurmshme, lagjja, etj.) mund të na ndryshojë dhe zgjerojë ndërgjegjen tonë të brendshme për mjedisin rrethues.” Panos Amelidis

Në varësi të qëllimeve të ndërhyrjes dhe ndjeshmërisë së kontekstit, aplikimet e tij shtrihen në disa fusha të punës pedagogjike dhe artistike. Për shembull, për pjesëmarrësit vulnerabël në moshë të re dhe jashtë qendrës së vëmendjes, vetëm aplikimi ndijor mund të jetë i përshtatshëm ose të shërbejë si një aktivitet i parë i nevojshëm nëse aplikimet e përsëritura janë të mundshme për një periudhë të mjaftueshme kohore; për pedagogjitë që merren me studentë tashmë të angazhuar, aplikacionet më të parastrukturuara dhe të orientuara nga detyra mund të përbëjnë një sfidë të përshtatur mjaft mirë. Kjo do të varet edhe nga objektivat e projektit, p.sh., nëse ndërhyrja pritet të sjellë përfitime personale terapeutike vetëm për pjesëmarrësit apo synon të krijojë zërin kritik dhe krijues të pjesëmarrësve të rinj brenda një mjedisi më të gjerë socio-politik. Në këtë manual përshkruhen të dyja mundësitë, të quajtura ‘Opsioni A’ dhe ‘opsioni B’, ndonëse ato janë pjesë e një vazhdimësie dhe çdo kombinim mes dy skajeve të këtij spektri është i mundur.

- ▶ **Opsioni A:** Kompozimi i peizazhit tingullor si një **angazhim ndijor dhe krijues** me mjedisin për të krijuar ndërgjegjësime dhe marrëdhënie të reja me të. Qëllimet mund të jenë krijuese, terapeutike, si dhe transformuese në aspektin personal, pedagogjik dhe njohës për secilin pjesëmarrës. Detyrat janë të hapura, ndijore dhe eksploruese (pa paracaktuara ose vendosura me ndonjë tematikë të caktuar).
- ▶ **Opsioni B:** Kompozimi i peizazhit tingullor, për shembull si një aplikim pedagogjik në klasa, i orientuar nga detyra të strukturuara, të paracaktuara (ose të dakordësuara), që synojnë forcimin e **të menduarit kritik dhe krijues**. Ai mund të ketë si qëllim

krijimin, hulumtimin në aspektin social dhe transformimin në aspektin njohës veçanërisht në lidhje me çështjet e drejtësisë sociale. Detyrat janë të strukturuar dhe kanë një qëllim të caktuar (p.sh., përfshirë fletët e punëve për fazën eksploruese); ato janë ndijore dhe eksploruese (tematikat specifike janë ose të paracaktuara ose të zgjedhura nga pjesëmarrësit).

Të dyja opsionet përdorin pajisje teknologjike për të dëgjuar, regjistruar dhe modifikuar tingujt, ndërkohë që i nxisin të rinjtë të përjetojnë dhe eksplorojnë mjediset e tyre në forma të ndryshme ku kërkohet vëmendje. Secili opsion mund të rrisë angazhimin e të rinjve me mjedisin e përditshëm duke u kërkuar atyre të vërejnë dhe të hetojnë në mënyrë krijuese tingujt që përfaqësojnë përvojat e tyre të përditshme.

Kjo qasje artistike dhe arsimore ka si bazë aftësinë për të kuptuar sa më mirë në aspektin teorik, së pari, studimet e peizazhit tingullor dhe kompozimin e peizazhit tingullor si një njësi që integron të dëgjuarit, mendimet, ndjenjat dhe kujtimet për të përjetuar botën. Së dyti, ai mbështetet në teoritë e zhvillimit me bazë arti dhe me pjesëmarrje që synojnë t'u ofrojnë të rinjve hapësira dhe mundësi për të shprehur historitë dhe shqetësimet e tyre, për t'u dëgjuar dhe respektuar dhe për t'u bërë agjentë të ndryshimit në shoqërinë e tyre.

- ▶ Në këtë manual ofrohen udhëzime për të **dy Opsionet A & B**. Është rezultat i Projektit RAYS, Palladium Albania, 2021-23, të financuar nga qeveria britanike, dhe i pari studim rasti me veprim me pjesëmarrje i kryer me të rinjtë në Shkodër në shtator 2022.

Ky manual bazohet në përvojën e Dr. Panos Amelidis si teknolog muzike, kompozitor, ekspert audio dhe studiues. Dr. Panos është lektor i teknologjisë muzikore dhe audios në Universitetin Bournemouth. Dr. Stephanie Schwandner Sievers, profesore e asociuar në antropologjinë e aplikuar, me mbështetjen e studiueses Emily Fisher, ka kontribuar në teorinë e ndërhyrjes me bazë arti me pjesëmarrje që synon hartimin, dokumentimin, zbatimin dhe përshkrimin e transformimeve njohëse të evokuara përmes angazhimit shqisor dhe të përfshira në konceptin FAM, të cilat do të përshkruhen më në hollësi në kapitujt e mëposhtëm.

Në **kompozimin e peizazhit tingullor** përfshihen tre hapa:

- Eksplorimi: të futesh në terren, të bësh një shëtitje zanore dhe të regjistrosësh peizazhin tingullor;
- Krijimi: editimi (përpunimi) i tingujve të regjistruar; dhe, në fund
- Ekspozimi: prezantimi i regjistrimit përfundimtar në një koncert, si një instalacion, një skedar audio ose i lidhur me materialin vizual.

Strategjia FAM shton hapa krijimi në bashkëpunim dhe vlerësimi para dhe pas:

- Një 'matje paraprake e pulsit' për qëndrimet dhe perceptimet e përditshme të pjesëmarrësve para fillimit të fazës së eksplorimit të peizazhit tingullor për të identifikuar, ose sipas rastit përcaktuar, temat përkatëse.

- Një 'matje e mëpasshme e pulsit' për përvojat njohëse-transformuese të pjesëmarrësve, p.sh., perspektiva e ndryshuar, kuptimi i vetvetes, mjedisit dhe/ose të tjerëve, në varësi të temës së shqyrtuar dhe që zakonisht kryhet në lidhje me fazën e ekspozimit.

Përkufizime:

Strategjia FAM është një teknikë me të cilën mund të hartohen, përshkruhen, zbatohen dhe vlerësohen projektet që kanë si qëllim lehtësimin e përvojave transformuese në aspektin social dhe të zhvillimeve njohëse përmes arteve. Ai e merr emrin nga proceset e 'familiarizimit' dhe 'shfamiljarizimit', që ndodhin kur artet e çdo zhanri nxisin kuptime dhe perspektiva të reja kritike-reflektive e alternative të vetes, të të tjerëve dhe të realiteteve sociale e kulturore. Ky potencial i arteve është përdorur prej kohësh, për shembull, në pedagogjinë kritike që synon fuqizimin e atyre që janë në margjinat e shoqërisë, dhe në pedagogjinë e teatrit kritik. "Familjarizimi" ndodh kur pjesëmarrësit mësojnë të kuptojnë dhe të ndjejnë veçoritë ose perspektivat e panjohura më parë në mjedisin e tyre social dhe natyror, të paraqitura këtu përmes "tingujve" që më parë nuk ishin vënë re, ishin anashkaluar ose thjesht të marra si të mirëqena. "Shfamiljarizimi" ndodh kur pjesëmarrësit mësojnë forma të reja për të parë ose dëgjuar dhe në këtë mënyrë perceptojnë në forma të reja ato veçori ose këndvështrime të njohura më parë në mjedisin e tyre, përfshirë këtu edhe tingujt. Edhe pse e harmonizuar me idenë se vetëm njohja paraprake e rrethanave nxit ndërmarrjen e veprimeve për ndryshimin e tyre si individ, strategjia FAM ndryshon nga Terapia Njohëse e Sjelljes (TNjS) në atë që këndvështrimi i saj është social-kulturor dhe antropologjik (etnografik-eksplorues), dhe jo terapeutike për individin (ndonëse nuk përjashtohen përfitimet terapeutike). Fokusi i kësaj strategjie është tek njohja, lidhja dhe kapërcimi ose sfidimi i strukturave të brendshme të përjashtimit brenda një shoqërie të caktuar, dhe u ofron komuniteteve, nëpërmjet arteve, teknikat për të riformësuar të ardhmen e tyre në forma më gjithëpërfshirëse dhe më kritike.

"Duke i kushtuar vëmendje e duke i dëgjuar me veshët hapur mirë këta tinguj si dhe duke përdorur teknologjinë e regjistrimit mund të transformojmë ndërgjegjësimin tonë për jetën e përditshme." (Panos Amelidis)

Kompozimi i peizazhit tingullor është një formë e re për të analizuar se si e përjetojmë botën, sepse veshi merr shumë më tepër informacion dëgjimor nga sa e kuptojmë vetë. Duke i përpunuar, përpiluar, kompozuar dhe paraqitur këta tinguj, mund të bëjmë kompozime të peizazhit tingullor që na bëjnë të mundur të dëgjojmë botën e njohur në forma të reja dhe të panjohura. Angazhimi në këtë proces bën të nevojshme që dëgjuesit të reflektojnë mbi mënyrën se si e përjetojnë botën rreth tyre dhe marrëdhëniet me të. Në shkollë, për shembull, mund të fillojmë të reflektojmë mbi tingujt që orientojnë sjelljen tonë. Marrëdhënia jonë me peizazhin tingullor të përditshëm është me rëndësi të madhe për lidhjen tonë me kulturën dhe njerëzit tanë. Kthimi i vëmendjes ndaj kësaj lidhjeje mund të ketë një efekt transformues

duke na bërë të mundur ta përjetojmë ndryshe botën e përditshme. E kuptojmë se nuk po vëzhgojmë thjesht botën, por po sjellim në mënyrë aktive botë të reja përmes ndërgjegjes sonë. Kompozimi i peizazhit tingullor (dhe praktika artistike në përgjithësi) na bën të mundur të zbulojmë botë të reja duke na dhënë mundësinë të ndjejmë ndryshe dhe të përfitojmë mundësi të tjera. Sipas Elliot Eisner, kjo është vlera e vërtetë e edukimit artistik: ai mund të transformojë vetëdijen tonë.

2. STUDIMET DHE TERMINOLOGJIA E PEIZAZHIT TINGULLOR

Fusha e studimeve të peizazhit tingullor na ofron strategji të vlefshme për thellimin e vetëdijes dëgjimore dhe përmirësimin e marrëdhënieve tona me mjedisin ku banojmë. Studimet e peizazhit tingullor janë një disiplinë që eksploron ambientin zanor dhe grupin e kudondodhur të tingujve që përcaktojnë jetën tonë të përditshme. Në vitet 1970, R. Murray Schafer (së bashku me H. Westerkamp dhe Barry Truax) ngritën një grup kërkimor dhe arsimor të quajtur Projekti Botëror i Peizazhit Tingullor (World Soundscape Project - WSP), i cili dokumentoi dhe analizoi peizazhet tingullore të zonave të ndryshme. Ky projekt synonte mbi të gjitha të edukonte dhe arkivonte, por edhe të ndihmonte në zhvillimin e "kompozimit i peizazhit tingullor".¹ Më shumë informacione për Projektin Botëror të Peizazhit Tingullor mund të gjeni në këtë adresë.

Qasja e miratuar në këtë manual fokusohet tek të dëgjuarit e thelluar (ose "të lartësuar"), te kalimi në shëtitje zanore për regjistrim dhe tek editimi (përpunimi) dhe prezantimi i kompozimeve të peizazhit tingullor. Është e rëndësishme të kuptohet terminologjia bazë të zhvilluar nga studiues si R. Murray Schafer dhe H. Westerkamp.

TINGULLI, TË DËGJUARIT DHE DËGJIMI

Tingulli është një koncept, një interpretim i variacioneve të niveleve të presionit atmosferik të perceptuara nga truri i njeriut. Është me rëndësi të madhe të kuptojmë se si dëgjojmë lloje të ndryshme tingujsh; një dallim është se ka një ndryshim midis të dëgjuarit (listening) dhe dëgjimit (hearing). Dëgjimi ndodh në mënyrë të pavullnetshme, një proces i subkoshencës, ndërsa në procesin e të dëgjuarit vëmendja përqendrohet në tinguj të veçantë. Ky dallim është bërë në të kaluarën, por disa nga përkufizimet më të konsoliduara janë "modaliteti i të dëgjuarit" nga Pierre Schaeffer, Michel Chion dhe Pauline Oliveros. Të dëgjuarit është një përpjekje që duhet kultivuar; ka nevojë për praktikë për të zhvilluar ndjeshmërinë e të dëgjuarit dhe ndërgjegjësimit për tingujt përreth. Studiuesit e tingullit kanë prezantuar teknika të ndryshme për të mprehur veshët tanë ndaj tingujve përreth, p.sh., të pushojmë së bëri tinguj për një kohë të caktuar, të bëjmë shëtitje zanore dhe të tjera.²

1 Truax, B., 2002. 'Genres and Techniques of soundscape composition as developed at Simon Fraser University'. *Organised Sound*, 7(1), 5-14.

2 Schafer, R. M., 1977. *The soundscape: our sonic environment and the tuning of the world*. Rochester, V.T.: Destiny Books.

ÇFARË ËSHTË PEIZAZHI TINGULLOR

Sipas Murray Schafer, peizazhi tingullor përkufizohet si çdo ambient zanor, i cili mund të jetë aktual ose një "ndërtim abstrakt siç janë kompozimet muzikore dhe montazhet e kasetave, veçanërisht kur konsiderohet si një mjedis".³ Hildegard Westerkamp, bashkëpunëtor i Schafer dhe kontribuues kritik në fushën e hulumtimeve të peizazhit tingullor, e trajton më tej duke e përshkruar peizazhin tingullor si "studimin e ndërlidhjes mes tingullit, natyrës dhe shoqërisë".⁴ Në peizazhin tingullor përfshihen studimet metodike të një mjedisi të caktuar për të kuptuar pikat ku takohen sjelljet shoqërore dhe dukuritë natyrore përmes studimit të tingujve. Për shembull, Schafer propozoi shëtitjet zanore si formë mjaft e dobishme për të prezantuar "pastrimin e veshëve" në shkollë.⁵ Ideja e peizazhit tingullor i referohet ambientit natyror akustik që përbëhet nga tingujt natyrorë, përfshirë këtu zhurmat e kafshëve, tingujt e motit dhe elementë të tjerë natyrorë; dhe tingujt mjedisorë të krijuar nga njerëzit përmes kompozimit muzikor, projektimit të tingullit dhe aktiviteteve të tjera njerëzore, përfshirë këtu bisedat, punën dhe tingujt me origjinë mekanike. Dikujt mund t'i vijë në mend mjedisi zanor kur bie fjala për mënyrën sesi mjedisi i dëgjuesit prezantohet vetë përmes tingullit, ashtu siç e prezantojnë veten vizualisht peizazhet.

Shëtitja zanore mund të përkufizohet si "çdo ekskursion, qëllimi kryesor i të cilit është të dëgjuarit e mjedisit" (Westerkamp, 2007, f. 1)

ÇFARË ËSHTË SHËTITJA ZANORE?

Hildegard Westerkamp e përkufizon shëtitjen zanore si "çdo ekskursion, qëllimi kryesor i të cilit është të dëgjuarit e mjedisit."⁶ Ky term u përdor për herë të parë nga anëtarët e Projektit World Soundscape të Murray Schafer dhe që atëherë është zhvilluar, ndër të tjerë, nga Westerkamp, Andra McCartney dhe Janet Cardiff. Ky veprim i ecjes për të shëtitur dhe për të dëgjuar me vëmendje të çdo tingull në mjedis është një metodë e dobishme për t'u përfshirë me peizazhet tingullore. Përveç kësaj, shëtitja zanore është një aspekt rëndësishëm i fazës së regjistrimit të kompozimit të peizazhit tingullor. Ajo fokusohet në ecjen dhe në të dëgjuarit aktiv, duke krijuar potencialin për të hapur veshët dhe mendjet tona ndaj tingujve brenda nesh, rreth nesh dhe peizazhit tingullor të botës. Këto shëtitje janë një përvojë e të dëgjuarit në lëvizje dhe ofrojnë një zhvendosje të vëmendjes që mund të ndryshojë mënyrën se si kujdesemi për botën. Praktika e Westerkamp përfshin shëtitje zanore me regjistrim audio dhe një "eksplorim të marrëdhënies vesh-mjedis, të pandërmjetësuar nga mikrofonat, kufjet dhe pajisjet e regjistrimit".

3 Po aty., p. 275.

4 Westerkamp, H., 2002. Linking soundscape composition and acoustic ecology. Organised Sound, 7, 51–56, p. 52.

5 Schafer, R. M., 1977. The soundscape..., p. 213.

6 Westerkamp, H., 2002. Linking soundscape ..., p. 1.

Schafer bën dallimin mes dy llojeve:

1. Shëtitja dëgjimore është shëtitje ku pjesëmarrësit fokusohet tek të dëgjuarit në heshtje.
2. Shëtitja zanore do të eksplorojnë peizazhin tingullor të një zone të caktuar si dhe mund të përfshijë edhe ushtrime për pastrimin e veshëve dhe nxjerrjen e zërit nga pjesëmarrësit për të eksploruar tingujt e mjedisit dhe për të qenë të vetëdijshëm për tingujt e dikujt tjetër. Pjesëmarrësit bëhen 'kompozitorë-interpretues'.⁷

Shëtitja zanore mund të konsiderohet një kompozim primitiv i peizazhit tingullor. Në një shëtitje zanore, kompozitori lëviz nëpër mjedisin e zgjedhur, duke dëgjuar dhe regjistruar tingujt që dëgjon gjatë rrugës. Kompozitori mund të ftojë pjesëmarrës të ndryshëm të marrin pjesë në përvojën e shëtitjes zanore dhe mund të përfshijë ose mund të mos i përfshijë vëzhgimet dhe reflektimet e tyre vokale në regjistrim. Të organizuara në të gjithë botën, shëtitjet e sotme zanore shpesh marrin formën e një eventit publik ku theksohet ndërgjegjësimi dhe angazhimi me mjedisin, zakonisht në një mjedis urban. Shëtitje të tilla evidentojnë natyrën e mishëruar të të dëgjuarit në shkallën njerëzore. Në një shëtitje zanore, teknikat kompozicionale bëhen lëvizjet fizike të trupit të regjistruarit. Kur ai/ajo ec, ndalon, kthehet ose ndryshon ritmin e hapit, ndryshon edhe këndvështrimi i peizazhit tingullor.⁸

ÇFARË ËSHTË KOMPOZIMI I PEIZAZHIT TINGULLOR?

Kompozimi i peizazhit tingullor është një proces krijues specifik i të dëgjuarit, regjistrimit, editimit dhe paraqitjes së peizazheve tingullore në kontekste të shumanshme. Ky term huazon shumë nga komponentët kyç të identifikuar nga Schafer dhe bashkëkohësit e tij; këto kompozime janë një studim i kujdesshëm i peizazheve tingullore të kulturës sonë. Përveç kësaj, i është kushtuar më shumë vëmendje ndërhyrjes krijuese në këto hapësira dëgjimore përmes akteve të incizimit dhe mbledhjes së tingujve, editimit dhe kompozimit të skedarëve audio dhe prezantimit të projekteve të përfunduara si regjistrime audio, instalacione artistike ose video art. Truax shpjegon se pjesët e peizazhit tingullor mund t'i motivojnë dëgjuesit të përqendrohen dhe t'i eksplorojnë tingujt më thellë, duke i dëgjuar ato në një formë të panjohur më parë sesa në jetën e përditshme.⁹ Westerkamp beson se vetë të dëgjuarit është pjesë e rëndësishme përbërëse e kompozimit të peizazhit tingullor dhe se praktika e rregullt e të dëgjuarit do t'i sjellë dobi kompozitorit duke përmirësuar marrëdhënien me mjedisin akustik.¹⁰

Kompozimi i peizazhit tingullor është një pjesë muzikore e destinuar për t'u luajtur që përfshin tingullin aktual të regjistruar nga mjediset natyrore ose urbane. Shpesh këto incizime i bën kompozitori. Ky i fundit mund t'i përpunojë më vonë në studio tingujt e regjistruar (duke përdorur softuer të posaçëm për përpunimin dhe miksimin e audios), të

7 Schafer, R. M., 1977. The soundscape..., p. 213.

8 Paquette, D. and McCartney, A., 2012. Soundwalking and the bodily exploration of places, p. 135.

9 Truax, 2002. 'Genres and Techniques...', p. 219.

10 Westerkamp, H., 2002. Linking soundscape ..., p. 53.

shkëpusë elementë nga regjistrimi, të kombinojë regjistrime nga vende të ndryshme, të përpunojë tingujt e regjistruar, etj. Në kompozimin e peizazhit tingullor, mikrofoni kthehet në një lloj instrumenti muzikor në vetvete. Ashtu si objektivet e aparatit fotografik apo mikroskopët, mikrofoni mund të "rrisë ose shtrembërojë perceptimin tonë për pjesë të veçanta të mjedisit tonë shqisor."¹¹

"Në kompozimin e peizazhit tingullor, mikrofoni kthehet në një lloj instrumenti muzikor në vetvete." (Derrick, 2014)

Regjistrimi i zërit bëhet në forma të ndryshme, nga podkastet, kompozimet e peizazheve tingullore, dokumentarë zanorë, rrëfimet me gojë e deri tek shëtitjet zanore të regjistruara. Të gjitha këto forma janë akte përfaqësimi dhe interpretimi. Në to përfshihen përzgjedhje (dhe editime) të kujdesshme të klipeve të veçanta zanore dhe procesi i krijimit të një narrative. Ato krijojnë forma të reja të njohjes dhe përjetimit të botës. Përdorimi krijues i regjistrimit zanor ofron një mundësi ideale për zbatimin e strategjisë FAM: duke i shndërruar gjërat e zakonshme dhe të njohura për nga pamja (ose tingulli) në diçka të pafamiljarizuar e të jashtëzakonshme. Kompozimi i peizazhit tingullor e shndërron botën e zakonshme në një botë të jashtëzakonshme. Kompozitori përdor pajisjet e regjistrimit të zërit, montazhit, paraqitjes zanore dhe metaforave, duke i shfamiljarizuar aspektet e përditshme të realitetit dhe duke i përfaqësuar ato nga një këndvështrim tjetër.

11 Derrick, R. G., 2014. Acoustic illuminations: recorded space as soundscape composition [në internet] Music Dissertation, University of Canterbury. Available from: Acoustic illuminations: recorded space as soundscape composition (canterbury.ac.nz)

3. TË KUPTOJMË VENDIN NËPËRMJET TË DËGJUARIT

Siç e përshkruar edhe Zečo, akti i të dëgjuarit "luan një rol në prodhimin e njohurive për atë vend."¹² Ajo vazhdon:

*vendet ku dëgjon me vëmendje dhe mënyra si përjetohej të dëgjuarit mbështesin nocionet socio-politike të vendit. Ndërveprimet ndërmjet faktorëve socialë në kontekstin e klasës, racës, gjinisë, identiteteve etnike, e kështu me radhë, krijojnë forma materiale kulturore si arkitektura, monumentet publike dhe emrat e rrugëve. Faktorë të tillë mund të shprehen ndryshe në lagje apo hapësira e përbashkëta.*¹³

Kur regjistrujmë tinguj, mund të zbulojmë aspekte të padukshme të jetës kulturore, të jetës njerëzore e jo-njerëzore dhe të objekteve të pajeta, komponentë që janë të rëndësishëm për të bërë të mundur të kuptojmë vendin në këndvështrimin socio-politik, siç përjetohej nga dëgjuesi i ndërgjegjësuar. Shëtitja zanore është akti i të dëgjuarit me vëmendje. Regjistrimet në terren janë metoda të konsoliduara që përdoren nga kompozitorët për të dëgjuar aktivisht vendet dhe shpesh përdoren si mjet për të mbledhur regjistrime dhe më pas për t'i hedhur ato në krijime e kompozime zanore, të quajtura kompozime të peizazheve tingullore. Është e rëndësishme të trajnojmë veshët tanë për të vlerësuar gamën e përvojave zanore që mund të ofrojë mjedisi zanor. Schafer sugjeron disa ushtrime për "të stërvitur veshët" që duhet të praktikohen gjatë shëtitjeve zanore (p.sh. krahasimi i zhurmës së kanaleve dhe tubacioneve të ujërave të shiut në një rrugë qyteti). Gjatë shëtitjes zanore, njerëzit nxiten të njohin tiparet e ndryshme estetike të tingullit të përjetuar, të tilla si tingujt e lartë dhe të ulët, gjestet dhe teksturat.¹⁴

12 Zečo, M., 2021. Listening and Recording In Situ: Entanglement in the sociopolitical context of place. *Organised Sound*, 26(2), 284-290, p. 284

13 Po aty, p. 284

14 Schafer, R. M., 1977. The soundscape...

4. REGJISTRIMI SI PROCES TRANSFORMIMI

Procesi krijues i kompozimit të peizazheve tingullore kërkon që dikush të dalë për një shëtitje zanore dhe të regjistrojë tingujt e trafikut, të zogjve, makinave, stacioneve të metrosë, fëmijëve që luajnë dhe një lumi që rrjedh në qytetin e tyre. Për të bërë këtë regjistrim, duhet thjesht të përdorim mikrofoni e celularit. Të dëgjosh me kufje hapësirat e njohura ndryshon nga perceptimi i zakonshëm i mjedisëve. Si rezultat, ndjesia e dëgjimit rritet dhe ka mundësi që të dëgjojmë tinguj të shumtë që përzihen në sfond. Për shembull, kur e drejtojmë mikrofoni drejt tokës gjatë shëtitjes, mund të dëgjojmë zhurmën e këpucëve në trotuar. Kjo përvojë rrit vlerësimin dhe ndjeshmërinë tonë ndaj tingujve rreth nesh edhe kur nuk i përdorim këto pajisje. Mund t'i ndryshojmë zakonet, si për shembull, të dëgjojmë muzikë me kufje duke qenë në një mjedis me audio mjaft argëtuese. Për më tepër, përdorimi i teknologjisë së regjistrimit për të drejtuar perceptimin e dikujt për tingullin mund të jetë një mjet për të reflektuar mbi vetëdijen e tij/saj për botën e jashtme. Të dëgjuarit dhe regjistrimi kanë një efekt transformues në ndërgjegjësimin tonë për mjedisin e zakonshëm. Duke edituar/përpunuar tingujt e regjistruar, mund të krijojmë vepra arti në formën e kompozimeve të peizazheve tingullore. Këto kompozime ruhen si skedarë audio dixhitalë dhe na japin fragmente të përvojave të dikujt për jetën në qytet. Si vepër artistike, ato kanë rezonancë dhe kuptim personal. Gjithsesi, ato mbeten të hapura ndaj interpretimit të dëgjuesve që i kuptojnë përmes përvojave të tyre. Në planin e seminarit të përfshirë në këtë dokument, bëjmë propozime për mënyrën e zbatimit në klasa për të rinj të procesit krijues të të dëgjuarit, regjistrimit, përpunimit dhe prezantimit të kompozimeve të peizazheve tingullore.

5. EDITIMI – BURIME NË INTERNET

Burime të tjera që lidhen me fushën e studimeve të peizazhit tingullor si dhe mënyrën e përdorimit të programeve falas për editimin zanor mund të gjenden në adresat e mëposhtme. Praktikantët e interesuar në zbatimin e kompozimit të peizazhit tingullor në klasë u rekomandohet të vizitojnë faqet e internetit të propozuara, si më poshtë.

<http://sounds.bl.uk/sound-maps/>

<https://www.sfu.ca/~truax/wsp.html>

<http://www.acousticecology.org/>

<http://www.sfu.ca/sonic-studio.html>

<https://www.youtube.com/watch?v=yzJ2VyYkmaA> (udhëzues praktik për aplikacionin Audacity)

6. ZBATIMI NË ARSIM – STRATEGJIA FAM

Kompozimi i peizazhit tingullor mund të përdoret si instrument arsimor në klasa. Kur zbatohet në këtë kontekst, mësuesit ose mund të identifikojnë, së bashku me pjesëmarrësit, ose të përcaktojnë tema specifike me rëndësi pedagogjike, duke përdorur procesin krijues transformues të kompozimit të peizazhit tingullor. Duke qenë se ky potencial është i nevojshëm për të nxitur ndjeshmërinë dhe tolerancën në të gjithë shtresat e shoqërisë, temat shembuj që mund të jenë rëndësishme dhe të dobishme për t'u eksploruar nga të rinjtë mund të lidhen me gjininë, moshën, klasën, përkatësia etnike ose ndarje të tjera në shoqëri. Këta shembuj mund të hulumtohen së bashku me tingujt që gjenden në hapësirat që përcaktojnë ndarje të tilla shoqërore (p.sh. grupet e marginalizuara mund të jetojnë në hapësira me ndotje kaustikë më të madhe sesa grupet e privilejuara).

Për praktikantët, njohuritë e tyre për aftësitë dhe dobësitë e pjesëmarrësve janë të një rëndësie të madhe. Për grupe të ndryshme të rinjsh mund të kërkohet ndryshim dhe përshtatje e strategjisë FAM për të shmangur tjetërsimin ose shkëputjen e tyre. Po ashtu, rol mund të luajnë edhe nevojat praktike për kohën dhe hapësirën. Një avantazh i kompozimit të peizazhit tingullor si praktikë ndërhyrjeje me të rinjtë e cenueshëm është natyra e tij joverbale e eksplorimit dhe rrëfimit. Prandaj, realizimi i një ushtrimi për matjen paraprake të pulsit për qëndrimet e pjesëmarrësve bazuar në teknika jo-verbale dhe jo të shkruara (p.sh. rrëfimi muzikor) mund të jetë më i përshtatshëm se sa realizimi i një sondazhi për të evidentuar qëndrime dhe perspektiva aktuale, nëse e lejon koha. Nga ana tjetër, planifikimi i ushtrimit duhet të bëhet sipas shkallës së strukturimit paraprak të aktivitetit, në varësi të objektivave të tilla si rezultatet që lidhen me temën. Këto do të duhet të zgjidhen mes opsioneve të mëposhtme, ose duke vënë në skenë një nga dy opsionet e paraqitura më sipër:

- ▶ **Opsioni A:** të zhyt në mendime dhe ndjesi: i përqendruar rreth angazhimit të shqisave dhe rrëfimit personal. E pastrukturuar, me fokus që mbizotëron tek aftësitë teknike dhe proceset praktike krijuese. Seancë me ritme të shpejta, më të shkurtra për një periudhë më të gjatë kohore, ideale për vlerësime me gojë.
- ▶ **Opsioni B:** bazohet në të menduarit kritik dhe krijues: Strukturuar rreth një teme orientuese, me theks në ndryshimin e perspektivës dhe kapërcimin e kufijve shoqërorë për t'u njohur me perspektivën e të tjerëve dhe duke vlerësuar ndryshimet në qëndrimet e pjesëmarrësve. Ky opsion është një mjet i dobishëm për adresimin e strukturave të brendshme të përjashtimit.

Përkufizime:

Të menduarit kritik – citate të zgjedhura:

- 'Të menduarit kritik është të menduarit reflektues dhe me arsyesim që përqendrohet në marrjen e vendimit se çfarë të besosh apo të bësh.'¹⁵
- Është 'përdorimi i qëllimshëm i aftësive dhe strategjive që rrisin probabilitetin e rezultateve të dëshirueshme.'¹⁶
- "Të menduarit kritik do të thotë të shohësh të dy anët e një çështjeje, të jesh i/e hapur ndaj provave të reja që kundërshtojnë idetë që ke, të arsyetosh pa pasion, të kërkosh që pretendimet të mbështeten nga prova, të analizosh dhe të dalësh në përfundime nga faktet e disponueshme, të zgjidhësh probleme, e kështu me radhë.'¹⁷

Të menduarit krijues – citate të zgjedhura:

- Krijimi i ideve atipike që ndryshon nga perceptimet aktuale individuale.¹⁸
- Anasjelltas, kreativiteti mbështetet tek "të menduarit ndryshe, duke iu referuar aftësisë për të krijuar zgjidhje të shumta alternative për pyetjet pa një përgjigje të vetme."¹⁹

MATJA PARAPRAKE E PULSIT, MATJA E MËPASSHME E PULSIT DHE FLETAT E DETYRAVE:

Për zbatimin e bazuar në FAM kërkohen praktika vlerësimi që veprojnë si evidenca të praktikës së zgjedhur për ndërhyrjen me bazë arti, këtu kompozimi i peizazhit tingullor, për të ndikuar në transformimin e perspektivave dhe nxitjen e përfshirjes me grupin e pjesëmarrësve. Këto faza të vlerësimit njihen si matja paraprake dhe e mëpasshme e pulsit (shih më lart). Ato duhet të ndodhin në fillim dhe në fund të ndërhyrjes me peizazh tingullor. Do të ishte ideale që në matjen paraprake të pulsit të ketë sa më pak ndërhyrje nga organizatorët, me qëllim që të zbulohen perspektivat aktuale pa rezerva të pjesëmarrësve para se të marrin pjesë në ndërhyrje. Një metodë e përshtatshme dhe mjaft tërheqëse për t'u përdorur në matjen paraprake të pulsit është ajo e elicimitit muzikor. Në varësi të objektivave pedagogjike, pjesëmarrësit mund të informohen për temën para se të vendosin për muzikën që do të përfaqësojë opinionet e tyre, ose (pasi janë informuar se seminari synon të trajtojë ndarjet shoqërore), tema mund të lindë nga

15 Ennis, R. H. 1985. A logical basis for measuring critical thinking skills. *Educational Leadership*, 43(2), 44–48, p. 45.

16 Halpern, D. F. 1998. Teaching critical thinking for transfer across domains: Dispositions, skills, structure training, and metacognitive monitoring. *American Psychologist*, 53(4), 449–455, p. 449.

17 Willingham, D. T. 2007. Critical thinking: Why is it so hard to teach? *American Educator*, 8–19, p. 8.

18 Finke, R. A., 2014. *Creative Imagery: Discoveries and Inventions in Visualization* [në internet]. 1st Edition. New York: Psychology Press.

19 Groyecka-Bernard, A., Karwowski, M., and Sorokowski, P., 2021. Creative thinking components as tools for reducing prejudice. Evidence from experimental studies on adolescents. *Thinking Skills and Creativity* [në internet], 39, p. 3.

një diskutim dhe konsensus rreth këngëve që shprehen në vlerësimin paraprak (matja e pulsit). Secili pjesëmarrës duhet të inkurajohet të diskutojë me grupin pse ka zgjedhur një këngë të caktuar dhe se si, dhe pse, ajo këngë përfaqëson perspektivën e tij/saj. Nëse del e nevojshme që ndërhyrja të shkurtohet, do të ishte mirë të përdoren pyetësorët me letër (shih shembullin e pyetësorit të matjes paraprake në Shtojcën 1). Për qëllime të vlerësimit, kjo më pas mund të krahasohet me materialin e prodhuar pasi të ketë mbaruar seminari, pra matja e mëpasshme. Këto matje mund të formatohen në mënyra të ndryshme, por ofrojnë provat më të mira që evidentojnë qëndrime dhe mendime para-ekzistuese dhe në ndryshim, qoftë përmes shënimeve, pyetësorëve, intervistave joformale dhe regjistrimit të zërit (me lejen e pjesëmarrësve), ose diçka e ngjashme (shih dokumentin e konceptit FAM).

“Fleta e punës ishte mjaft e dobishme dhe më bëri të mundur të kem ide të reja dhe t’i shpreh ato me më shumë lehtësi.” Koment pas matjes së mëpasshme të pulsit, pjesëmarrëse femër, Shkodër.

Nuk duhet të kryhet asnjë ndërhyrje dhe vlerësim pa konsideratat e duhura etike dhe, në rastin e hulumtimit, miratimin e etikës së hulumtimit, për të siguruar të drejtën e pjesëmarrësve për të dhënë pëlqimin e tyre të bazuar në informacion, për t’u tërhequr në çdo kohë, për të qenë anonimë dhe për t’u mbrojtur të dhënat në përputhje me ligjet në fuqi.

Kapitujt e mësipërm na ndihmuan të kuptojmë në një farë mënyre kompozimin e peizazhit tingullor si praktikë, histori dhe koncept, si dhe zbatimin e tij – më vete apo në kombinim me aplikimin strategjik FAM – si mjet i transformimit njohës dhe social në punën me të rinj dhe në procesin mësimor.

Pjesa tjetër e manualit përbëhet nga një plan i adaptueshëm hap pas hapi i seminarit për të orientuar praktikantët në zbatimin e kompozimit të peizazhit tingullor gjatë punës me të rinjtë.

7. PLANI I SEMINARIT

KËRKESAT TEKNIKE

Skenari i trajnimit mund të realizohet në një sallë me kompjuterë apo në një laborator informatike. Janë të nevojshme një pajisje regjistrimi (telefona celulare) dhe një pajisje që mund të luajë muzikë.

LISTA E PAJISJEVE

- Kufje
- Telefona celulare (iOS ose Android)
- Aplikacioni Audacity me shtojcat FFMpeg të instaluara.
- Kompjuter (me Audacity të instaluar)

QËLLIMET

Ky plan seminari është hartuar për të inkurajuar trajnerët që të organizojnë një seminar të kompozimit të peizazhit tingullor në klasë (ose si alternativë, në një qendër rinore, ose në mjedise të tjera profesionale formale ose joformale për të rinj). Ai synon të zhvillojë të dëgjuarit aktiv të pjesëmarrësve dhe të rrisë ndërgjegjësimin e tyre për tingujt dhe peizazhet tingullore që i rrethojnë. Ai kërkon të kuptojë rëndësinë e përvojës dëgjimore, e cila mund të kontribuojë në ndjenjën e "përkatësisë" ndaj një komuniteti dhe mjedisit. Përveç kësaj, ai synon t'i ndihmojë pjesëmarrësit të zbulojnë botën e padukshme por magjike të tingujve. Së fundi, ai ka si qëllim që ta përdorë këtë lëndë të parë në kompozimin e muzikës origjinale dhe shprehjen e emocioneve përmes mënyrave krijuese dhe novatore.

Qasja do të realizohet përmes një procesi që përfshin kërkimin, aventurën dhe kreativitetin. Fillimisht, pjesëmarrësit do të njohin dhe karakterizojnë tingujt nga përditshmëria e tyre, duke u fokusuar në rëndësinë e tingujve dhe ndikimin e tyre në cilësinë e jetës së njerëzve. Kombinuar me zbatimin e strategjisë FAM, pjesëmarrësit mund të orientohen të eksplorojnë tema të paracaktuara që janë tregues të ndarjeve shoqërore (p.sh. eksplorimi i tingujve të hapësirave femra kundrejt meshkujve). Më pas pjesëmarrësit do të regjistrojnë një shëtitje zanore në zonën e tyre. Më në fund, ata do të mësojnë se si të përdorin një program kompjuteri për editimin audio për të krijuar mjedise zanore.

"Zbatimi i bazuar në informacionet nga FAM synon të nxisë krijimin e një urë për ndarjet shoqërore, duke përqafuar perspektiva alternative, duke rritur aftësitë e të menduarit krijues dhe kritik dhe duke avancuar transformimin njohës."

Objektivat e mësimit:

- Të regjistrojnë tingujt e zonës, jetës së përditshme dhe mjedisit social
- Të njohin dhe vlerësojnë tingujt e mjedisit nëpërmjet të dëgjuarit aktiv.
- Të kuptojnë vlerën e shqisës së dëgjimit për jetën e njeriut.
- Të njohin se si tingulli mund të ndihmojë në identifikimin, përcaktimin dhe paraqitjen e hapësirave të ndryshme shoqërore.
- Të karakterizojnë dhe vlerësojnë tingujt dhe muzikën duke përdorur termat e duhur.
- Të krijojnë ë forma të reja për të treguar një histori nëpërmjet kompozimit të një mjedisi zanor.

Koha e nevojshme: të paktën 4 orë – mund të zbatohet në seanca të shkurtra trajnimi.

Niveli i vështirësisë: Mesatare

Lloji i veprimtarisë: Të dëgjuarit aktiv

Niveli i interaktivitetit: I lartë

Faza 1

Hyrje në konceptet e peizazhit tingullor

Vetëm Opsioni B

Matje paraprake e pulsit të pjesëmarrësve, orientuar nga FAM, përmes diskutimeve, elicimit muzikor ose pyetësorëve: krijimi i perspektivave ekzistuese për mjedisin social ose natyror. Nëse tema vendoset përmes diskutimit me matje paraprake të pulsit, organizatorëve do t'u duhet të vendosin se cila temë ishte më e përhapur përpara se të vazhdonin.

Opsioni A & B

AKTIVITETI I NXËNËSIT

Kohëzgjatja: 10 minuta

Vendi: klasë

Aktiviteti ku mësuesi i kërkon nxënësve:

- Të shkruajnë tre tinguj që sapo kanë dëgjuar kur janë zgjuar nga gjumi.
- Më pas, të shkruajnë tre tinguj që kanë dëgjuar kur kanë ardhur në shkollë.
- Më pas, të shkruajnë tre tinguj që dëgjojnë aktualisht brenda ose jashtë klasës.
- Më pas, të tre tinguj që u pëlqejnë (jo muzikor).
- Në fund, të shkruajnë tre tinguj që nuk u pëlqejnë.

U kërkohet nxënësve të ndajnë tingujt që kanë shkruar në klasë dhe nxiten diskutime rreth rëndësisë së tingujve në jetën e tyre.

Vetëm Opsioni B

Nëse ndiqet një ndërhyrje krijuese dhe kritike e drejtuar nga FAM, kjo do të ishte koha e duhur për t'u kërkuar pjesëmarrësve të mendojnë për tingujt që lidhen me temën specifike, p.sh. tingujt që lidhen me hapësirat për meshkuj/femra, tingujt që lidhen me përjashtimin, tingujt që lidhen me ambientalizmin.

Opsioni A & B

AKTIVITETI I MËSUESIT

Kohëzgjatja: 10 minuta

Vendi: klasë

Modalitetet e të dëgjuarit

Mësuesi përcakton "tingullin" dhe evidenton dallimin e tij nga "audio".

Tingulli: variacionet e nivelit të presionit në atmosferë që arrijnë në veshët tanë interpretohen si tinguj.

Audio: tingull i riprodhuar nga media (analoge apo digjitale). Nuk përfshihet njeriu por pajisja.

Mësuesi u ofron nxënësve një ide të re: ne dëgjojmë në mënyra të ndryshme.

Ne e dëgjojmë dikë a diçka, dhe me ndërmjetësimin e tingullit, duke synuar të identifikojmë burimin, shkakun, e trajton tingullin si shenjë të këtij burimi.

Ne dëgjojmë shumë gjëra që nuk po përpiqemi t'i dëgjojmë aktivisht dhe as t'i kuptojmë në mënyrë pasive. Dëgjimi është i pavullnetshëm.

Faza 2

Të menduarit e peizazhit tingullor

Opsioni A & B

AKTIVITETI I NXËNËSIT

Kohëzgjatja: 10 minuta

Vendi: klasë

Mësuesi/ja u kërkon nxënësve të vështrojnë një pikturë dhe të imagjinojnë se cilët do të ishin tingujt që dëgjojnë nëse do të ishin në prani të këtij peizazhi? Në grup, studentët duhet të shkruajnë përgjigjet e tyre dhe më pas t'i prezantojnë ato në klasë.

Shembull pikturë për t'u përdorur: Albert Bierstadt "Në Sierra Nevada".

Vetëm Opsioni B

Organizatorët mund të zgjedhin të përdorin një pikturë që përfaqëson një temë të caktuar.

Opsioni A & B

AKTIVITETI I MËSUESIT

Kohëzgjatja: 10 minuta

Vendi: klasë

Çfarë është peizazhi tingullor?

Ideja e peizazhit tingullor i referohet ambientit natyror akustik që përbëhet nga tingujt natyrorë, përfshirë edhe zhurmat e kafshëve, tingujt e motit dhe elementë të tjerë natyrorë; dhe tingujt mjedisorë të krijuar nga njerëzit përmes kompozimit muzikor, projektimit të tingullit dhe aktiviteteve të tjera njerëzore, përfshirë këtu bisedat, punën dhe tingujt me origjinë mekanike.

Mendoni për peizazhet tingullore për sa i përket mënyrës sesi mjedisi i dëgjuesit prezantohet përmes tingullit, në të njëjtën mënyrë siç prezantohen peizazhet vizualisht.

Faza 3

Regjistrimi në terren dhe shëtitjet zanore

Opsioni A & B

AKTIVITETI I NXËNËSIT/MËSUESIT

Kohëzgjatja: 30 minuta

Vendi: klasë

Arti i regjistrimit në terren

Regjistrimi në terren është arti i kapjes së incizimeve audio jashtë një studioje regjistrimi. Regjistrimi në terren ka të bëjë vetëm me kapjen e audios drejtpërdrejt nga burimi, pavarësisht se ku ndodhet. Lënda e subjektit varion nga tingujt natyrorë deri te tingujt e krijuar nga njeriu.

Si të bëjmë një regjistrim në terren?

- Përdorim aplikacionin e regjistrimit audio nga celulari
- Bëjmë një shëtitje zanore
- Vendosim se cilët tinguj do të regjistrojmë
- Dëgjojmë me vëmendje burimin e tingullit
- Monitorojmë ndërkohë që regjistrojmë duke përdorur kufjet me mikrofon

Mësuesi do të demonstrojë se si të përdoren aplikacionet e regjistrimit audio për të kapur tingujt në klasë.

Më pas u kërkohet nxënësve të kapin tingujt në klasë (ata ndoshta mund të dalin nga klasa për këtë qëllim) duke përdorur telefonat celularë. Pastaj kthehen dhe dëgjojnë përsëri tingujt që kanë regjistruar.

Arti i shëtitjes zanore

Shëtitet aty ku pjesëmarrësi (ose pjesëmarrësit) mund të përqendrohen tek të dëgjuarit. Qëllimi kryesor i aktivitetit është të lehtësojë të dëgjuarit e lartësuar. Kur përfshihet më shumë se një person, pritët të ketë heshtje gjatë gjithë kohës (nuk ka bisedë gjatë shëtitjes). Zakonisht bëhen diskutime rreth tingujve, dhe shëtitja zanore, në fund.

Shëtitjet zanore mund të regjistrohen dhe të përdoren si burim tingujsh, ose të përdoren si frymëzim për vepra.

“Regjistrimi në terren është arti i kapjes së regjistrimeve audio jashtë një studioje regjistrimi.”

Faza 4

Ushtrimi i shëtitjes zanore

Opsioni A & B

AKTIVITETI I NXËNËSIT/MËSUESIT

Kohëzgjatja: 30 minuta

Vendi: jashtë klase

Do të regjistroni me telefon celular tingujt që dëgjoni teksa shëtisni, në mënyrë që t'i dëgjoni përsëri më vonë.

Kohëzgjatja e shëtitjes: 10 minuta.

Për çfarë keni nevojë:

- Kufje
- Telefona celularë (që shërben si pajisje regjistrimi/incizimi)

Rruga: Mund t'i hidhni një sy hartës dhe përpiquni të planifikoni një udhëtim që do t'ju çojë në disa zona të ndryshme (p.sh., shtëpitë e lagjes, fabrikë, lumë, rrugica ngjitur), por kaloni edhe në zonat kryesore të qytetit (p.sh., në qendrën e qytetit me kullën e shatit, stacioni i trenit, stacioni i autobusëve, qendër tregtare).

Kini parasysh: ju jeni **dëgjues!**

Faza 4.1

Dita e eksplorimit

(Opsioni A), Opsioni B

AKTIVITETI I NXËNËSIT

Kohëzgjatja: E gjithë dita

Vendi: Mjedisi personal/social

Në varësi të kohës në dispozicion për seminarin, do të ishte e dobishme që në këtë pikë t'u lejohej pjesëmarrësve një ditë eksplorimi në mënyrë të pavarur.

Të pajisur me njohuri konceptuale dhe praktike, pjesëmarrësit duhet të nxiten të eksplorojnë mjedisin e tyre larg seminarit për të regjistruar tinguj për krijimin e mjedisit të tyre zanor.

Nëse zbatohen me objektiva kritikë dhe krijues, aktivitetet praktike të të menduarit divergjent duhet të zhvillohen përpara shpërndarjes së pjesëmarrësve. Mund të hartohet një fletë detyre për një temë të caktuar për të nxitur marrjen e perspektivës alternative. Në Shtojcën 2 jepet një shembull i thjeshtuar i një flete të tillë detyrash, në këtë rast duke u fokusuar në normat gjinore.

Faza 5

Hyrje në editimin audio

Opsioni A & B

AKTIVITETI I NXËNËSIT/MËSUESIT

Kohëzgjatja: 30 minuta

Vendi: klasë

Mësuesi do të prezantojë tani funksionet bazë të editimit (përpunimit) audio duke përdorur programin Audacity. Fillimisht duhet të tregojnë se si importohet në Audacity audio e regjistruar dhe më pas të përdorin funksione editimi si prerja e tingujve, ruajtja e tyre si skedarë të veçantë, krijimi i fade-in/outs (zbehjes në hyrje/dalje) dhe ndryshimi i amplitudës së një tingulli.

Më pas, mësuesi/ja u kërkon nxënësve që të importojnë shëtitjet zanore në softuer dhe të bëjnë editime të ngjashme. Qëllimi është të përcaktohen ngjarjet e rëndësishme të zërit të incizuara në regjistrimin e tingullit dhe më pas t'i izolojnë ato dhe t'i eksportojnë si skedarë audio të veçantë, të gatshëm për t'u përdorur në një fazë të mëvonshme.

Faza 6

Kompozimi i një mjedisi zanor

Opsioni A & B

AKTIVITETI I NXËNËSIT/MËSUESIT

Kohëzgjatja: 60 minuta

Vendi: klasë

Bazuar në regjistrimin e shëtitjeve zanore, të modifikohen tingujt që kanë mbledhur në skedarë më të vegjël audio dhe të krijohet një studim kompozimi mjedisi zanor bazuar në një tregim ose ide që do të kenë nxënësit.

Mesazhi mund të jetë diçka përgjatë vijave të një përfaqësimi të një ideje (d.m.th. habi e madhe, përfshirje, diversitet kulturor).

Regjistrimi duhet të jetë 2-3 minuta i gjatë. Nxënësit nuk duhet të hezitojnë të eksperimentojnë me modifikime dhe përsëritje të ndryshme të tingujve.

Si shembull dëgjoni kompozimin "Bewilderment" nga Valerio Zanini.

Ja një adresë e kompozimit të Zaninit: <https://www.youtube.com/watch?v=5GIRjrUqm6g>

Këshilla praktike:

Eksploroni tingujt interesantë dhe unikë që gjenden në zonën tuaj.

Kompozimi i peizazhit tingullor mbështetet në të dëgjuarit e detajuar dhe editimin inteligjent.

Shpesh, ka një ndërthurje mes tingujve që janë në plan të parë dhe atyre që janë në sfond.

Tingujt mund të lëvizin, duke kaluar nga plani i parë në sfond ose anasjelltas.

Faza 7

Ekspozimi (dhe Matja e mëpasshme e pulsit)

Opsioni A & B

AKTIVITETI I NXËNËSIT/MËSUESIT

Kohëzgjatja: 1-2 orë

Vendi: klasë

Çdo pjesëmarrës do të ketë mundësinë për të ekspozuar mjedisin e tij/saj zanor tek pjesa tjetër e grupit. Duhet të nxiten diskutime për perspektivën dhe qëllimin e kompozicionit të gjithsecilit dhe për çdo vështirësi që hasën gjatë regjistrimit. Gjatë kësaj faze do të ishte po ashtu e dobishme të pyeteshin pjesëmarrësit se çfarë u pëlqente dhe çfarë nuk u pëlqente në këtë seminar, dhe çfarë mendojnë se kanë mësuar - kjo është për të vlerësuar se me sa mundësi do të përdoren këto aftësi për të ecur përpara dhe si mund të përmirësohet seminari për trajnimin e radhës.

Opsioni B

Nëse zbatohet strategjia FAM (duke zbatuar me një objektiv të të mësuarit dhe vlerësimit kritik dhe krijues), duhet të diskutohet edhe rreth të mësuarit në lidhje me detyrën e ditës. Pjesëmarrësit duhet të trajnohen për të shpjeguar se si përfaqëson kufirin shoqëror mjedisi zanor dhe çfarë mendojnë se kanë mësuar secili prej tyre. Pavarësisht paraqitjeve të punëve të secilit pjesëmarrës, organizatorët duhet të nxisin biseda mes pjesëmarrësve të grupit gjatë kësaj faze – në kompozime të ndryshme mund të paraqiten ide të ndryshme dhe këto dallime mund të kenë po aq fuqi për të nxitur ndryshime të pikëpamjeve dhe këndvështrimeve.

Kjo vepron si një mesazh "i matjes së mëpasshme të pulsit", që reflekton qëllimet e lartpërmendura dhe organizatorët është mirë të regjistrojnë me zë këtë ekspozim për qëllime vlerësimi. Mund të jepen pyetësorë për regjistrimet ose në rrethana të jashtëzakonshme.

"Nëse zbatohet kompozimi i peizazhit tingullor duke pasur në mendje një objektiv kritik dhe krijues, duhet të bëhen diskutime edhe për të mësuarit e detyrës me temë."

SUGJERIME NGA PJESËMARRËSIT

"[Mësova] për mënyrat e ndryshme që përdorin njerëzit për të shprehur pikëpamjet/opinionet e tyre të ndryshme për një apo shumë çështje" përgjigja e pjesëmarrësve, Shkodër.

"Imagjinata nuk njihet kufij. Edhe pse në fillim m'u duk e pamundur të punoja me diçka kaq të re, në fund gjithsesi arrita të merrja rezultate të kënaqshme." përgjigja e pjesëmarrësve, Shkodër.

"Kompozimi i peizazhit tingullor është një formë arti ku mund të shprehësh opinionet e tua." përgjigja e pjesëmarrësve, Shkodër.

PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT

Zbatimi i seminarit pilot për peizazhin tingullor u bëri të mundur studiuesve të përshtatnin programin fillestar për t'iu përgjigjur më mirë nevojave të pjesëmarrësve në seminarin e tjera. U vendos që dy mënyrat e zbatimit të ndërhyrjes do t'u jepnin organizatorëve të ardhshëm avantazhin për të përmbushur më mirë nevojat e të rinjve pjesëmarrës. Për shkak të kësaj, u hartuan dy qëllime të ndryshme dhe u përcaktuan hapat e shpjeguara më sipër (Opsioni A dhe Opsioni B).

Të rinjtë, në kuadër të këtij projekti pilot, prodhuan kompozime të rafinuara mjaft të mira që u shoqëruan me diskutime dinamike në grup. Kjo ishte në mbështetje të qëllimeve të strategjisë FAM, duke përdorur mediumet e artit krijues për të nxitur të rinjtë të angazhohen në perspektiva përtej përvojave të tyre të atypëratyshme.

SHËNIME PËRMBYLLËSE

Editimi i rafinuar mund ta shndërrojë një peizazh tingullor nga diçka "normale", "të përditshme" në diçka misterioze dhe të mrekullueshme. Montazhierët audio të filmave e bëjnë këtë gjë mjaft shpesh për t'i shtuar diçka më shumë fabulës së filmit dhe botës në të cilin zhvillohet ai.

Prandaj, peizazhi tingullor nuk është thjesht prezantimi i peizazheve tingullore të regjistruara paraprakisht, por tregimi i një fabule përmes kontrollit dhe manipulimit të këtyre ambienteve zanore të regjistruara më parë.

Për të përfunduar seminarin për kompozimin e peizazheve tingullore, mësuesi ose personi që merret dhe punon me të rinjtë mund të organizojë një aktivitet model ku nxënësit prezantojnë kompozimet e tyre të peizazheve tingullore në koncert. Koncerti mund të zhvillohet në klasë ose në një sallë të madhe në shkollë, ose në një qendër rinore. Më

te jua të gjitha mundësitë që të eksplorohe format e shpërndarjes së krijimit artistik tek një audiencë më e gjerë në bashkëpunim me të rinjtë, p.sh. duke krijuar një ekspozitë në internet.

“Editimi i rafinuar mund ta shndërrojë një peizazh tingullor “normal”, “të përditshëm” në diçka misterioze dhe të mrekullueshme.”

REFERENCAT

- Akbari, E., 2016. *Soundscape compositions for art classrooms*. *Art Education*, 69(4), 17-22.
- Berger, J., 2008. *Ways of Seeing*. London: Penguin.
- Boal, A., 1974. *Theatre of the Oppressed*. New York: Theatre Communications Group.
- Derrick, R. G., 2014. *Acoustic illuminations: recorded space as soundscape composition* [online] Music Dissertation, University of Canterbury. Available from: *Acoustic illuminations: recorded space as soundscape composition* (canterbury.ac.nz)
- Dumitru, D., 2019. *Creating meaning. The importance of Arts, Humanities and Culture for critical thinking development*. *Studies in Higher Education*, 44 (5), 870-879.
- Eisner, E. W., 1997. *Educating artistic vision*. Reston, V.A.: National Art Education Association.
- Ennis, R. H. 1985. *A logical basis for measuring critical thinking skills*. *Educational Leadership*, 43(2), 44-48.
- Freire, P., 1970. *Pedagogy of the Oppressed*. New York: Seabury Press.
- Garber, J., Frankel, S. A., & Herrington, C. G. 2016. *Developmental Demands of Cognitive Behavioral Therapy for Depression in Children and Adolescents: Cognitive, Social, and Emotional Processes*. *Annual Review of Clinical Psychology*, 12, 181-216
- Halpern, D. F. 1998. *Teaching critical thinking for transfer across domains: Dispositions, skills, structure training, and metacognitive monitoring*. *American Psychologist*, 53(4), 449-455.
- Myers, R., 2011. *The Familiar Strange and the Strange Familiar in Anthropology and Beyond*. *General Anthropology* [online], 18(2): 2, 7-9.
- Paquette, D. and McCartney, A., 2012. *Soundwalking and the bodily exploration of places*, p. 135.
- Schafer, R. M., 1977. *The soundscape: our sonic environment and the tuning of the world*. Rochester, V.T.: Destiny Books.
- Truax, B., 2002. *'Genres and Techniques of soundscape composition as developed at Simon Fraser University'*. *Organised Sound*, 7(1), 5-14.
- Westerkamp, H., 2002. *Linking soundscape composition and acoustic ecology*. *Organised Sound*, 7, 51-56.
- Willingham, D. T. 2007. *Critical thinking: Why is it so hard to teach?* *American Educator*, 8-19.
- Zećo, M., 2021. *Listening and Recording In Situ: Entanglement in the sociopolitical context of place*. *Organised Sound*, 26(2).

SHTOJCA 1: SHEMBUJ TË MATJES PARAPRAKE TË PULSIT (VETËM SI PYETËSOR)

Në Seksionin 1 mund të ketë pyetje më të përgjithshme, të tilla si mosha (nëse pjesëmarrësit ndryshojnë), gjinia ose çdo pyetje tjetër administrative që konsiderohet e përshtatshme. Emrat nuk duhet të kërkohen me qëllim që pjesëmarrësit të jenë të paidentifikueshëm.

1. Pritshmëritë dhe motivimet

1.1. Çfarë ju motivoi të merrni pjesë në këtë seminar?

1.2 Çfarë prisni të mësoni nga ky seminar i peizazhit tingullor?

3. Kuptimi teknik dhe aplikimi i kompozimit të peizazhit tingullor

3.1 A e dini se ç'është mjedisi zanor dhe kompozimi i peizazhit tingullor?

Po

Jo

3.1.2 Nëse Po, ku ke mësuar/dëgjuar më parë për të?

3.2. Kompozimi i peizazhit tingullor bazohet në: (zgjidhni ato që mendoni se janë të sakta)

Të dëgjuarit aktiv dhe regjistrim

Shkrimin e tekstit të këngës

Regjistrimin e intervistave

Tregimin e historive nëpërmjet tingujve

Aplikimin e aftësive në programe (si p.sh., Audacity)

Të kënduarit dhe regjistrim

3.3. A mund të parashikoni ndonjë vend ku mund të aplikoni kompozimin e peizazhit tingullor në të ardhmen?

4. Tregimi i historive nëpërmjet kompozimit të peizazhit tingullor

4.1. Përpara këtij seminari, a jeni marrë me tregim historish nëpërmjet shkrimit, muzikës, videos apo ndonjë forme tjetër arti?

Po

Jo

4.1.2. Nëse Po, cilat forma arti? _____

4.2. A mendoni se mjedisi zanor mund të përdoret për të treguar histori që kanë rëndësi?

Po

Jo

4.3. Çfarë lloj historish mendoni se janë të rëndësishme për t'u treguar nga të rinjtë?

4.4. A mendoni se normat gjinore në mjedisin tuaj i kufizojnë zgjedhjet që keni si i ri për të formësuar të ardhmen tuaj?

Po

Jo

4.4.1 Ju lutemi shpjegoni përgjigjen që dhatë për pyetjen e mësipërme:

SHTOJCA 2: SHEMBULL FLETE DETYRE PËR EKSPLORIMIN

1. A mund të identifikoni, në mjedisin tuaj, vende ku mund të banojnë vetëm burrat ose vetëm gratë?

- Burra:
- Gra:
- Në cilat vende bashkohen të dy gjinitë?

2. Cilat tinguj gjinorë mund të regjistroni në këto vende?

3. Në cilat vende nuk mund të hyni sepse jeni djalë i ri apo vajzë e re?

4. A mund të identifikoni tingujt që lidhen me mjedisin e një:

- Vajze të re:
- Gruaje në moshë:
- Djali të ri:
- Burri në moshë:

4.1 Çfarë dallimesh mund të evidentoni?

4.2 Mendoni se si mund t'i përshkruani përmes tingujve ndryshimet që keni zbuluar.

Për këtë ushtrim është me rëndësi të madhe që të mos regjistroni asnjë audio pa lejen e njerëzve në hapësirën që po regjistroni (nëse ka njerëz të pranishëm), dhe nuk duhet të regjistroni në vende që mund t'ju vënë në rrezik jetën ose sigurinë tuaj.

